

1.1 Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në Fazën e Parë, janë përkatësisht si më poshtë:

- Kandidatët e interesuar duhet të jenë të pajisur me Certifikatën e Sigurimit Industrial (CSI), e cila duhet të jetë:
 - Jo më e ulët se niveli i klasifikimit “Sekret”;
 - E vlefshme në momentin e prokurimit dhe të lidhjes së kontratës së klasifikuar;
 - Në përputhje me objektin specifik të prokurimit të klasifikuar.
- Kandidatët e interesuar duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të klasifikuara të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin:
 - a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit;
 - b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorëve Ekonomikë do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

- Për kontrata të realizuara me institucione shtetërore :
 - Kontratë;
 - Formular vlerësimi;
 - Situacion përfundimtar;
 - Akt kolaudimi;
- Për kontrata të realizuara me subjekte private :
 - kontrata përkatëse;
 - situacioni përfundimtar;
 - fatura tatimore (ku të shprehen qartë datat, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë);
 - Akt kolaudimi.

Operatorët ekonomikë duhet të kenë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës, i cili duhet të jetë pjesë e përvojës së operatorëve ekonomikë në fushën objekt prokurimi dhe të jetë i pajisur me CSP me niveli të klasifikimit jo më të ulët se “Sekret”.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë se për periudhën Qershor-Korrik 2021 kanë patur në dispozicion punonjësit si më poshtë:

- a) Numri mesatar për muaj i punonjësve për periudhën në fjalë nuk duhet të jetë më i ulët se 10 (dhjetë) punonjës (në këtë numër përfshihet edhe stafi drejtues).

Kjo të dëshmohet me Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën e sipërpermendur dhe të shoqërohet me list-pagesat e plotësuara rregullisht sipas formularit të përcaktuar E-SIG 025/a.

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës, bazuar në formatin e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” të ndryshuar.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- N.P-1 A Punime gërmimi në tokë;
- N.P-2 A Ndërtime civile dhe industriale;
- N.P-3 A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

Për punimet speciale të ndërtimit:

- N.S-4 A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në procedurë duhet të dorëzojë dokumentacionin në përputhje me kërkesat e përcaktuara si më sipër, në një zarf të mbyllur, jo transparent, të nënshkruar dhe vulosur nga ana e tyre. Autoriteti Kontraktor, do të shqyrtojë dokumentat e dorëzuara nga operatori ekonomik dhe do të vlerësojë nëse ky dokumentacion plotëson kërkesat e përcaktuara në njoftimin e kontratës.

Formulari i kërkesës për pjesëmarrje duhet të plotësohet sipas formatit të dokumenteve të tenderit të publikuara nga APP në seksionin Legjislacioni / Prokurime në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Faza 2 - Ftesa për Ofertë dhe vlerësimi: Autoriteti Kontraktor do të dërgojë një ftesë për ofertë tek Kandidatët të cilët kanë plotësuar kërkesat për para-kualifikim duke i ftuar të dorëzojnë ofertat sipas përcaktimeve në DT dhe të specifikimeve të përcaktuara në ftesën për ofertë. Ofertat do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Autoriteti Kontraktor për të përcaktuar ofertën, fituese.